



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Nr. 3320 Prot., Datë 26 . 7 .2016

PARTNERËT SHQIPËRI PËR  
NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Nr. 1010 Prot., Datë 2 . 9 .2016

MINISTRI I SHTETIT  
PËR ÇËSHTJET VENDORE  
KOORDINATOR KOMBËTAR  
KUNDËR KORRUPSIONIT

Nr. 4574 Prot., Datë 21 . 7 .2016

#### MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

**Për zbatimin e projektit “Zbatimi i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”**

Nisur nga vullneti i përbashkët institucional për të kontribuar në zbatimin e projektit “Zbatimi i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, projekt i cili realizohet me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Tiranë në kuadër të projektit MATRA përgjatë periudhës Qershor 2016 – Prill 2017, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore në rolin e tij si Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) shprehin angazhimin e tyre për këtë bashkëpunim, si më poshtë:

Në kuadër të:

- Një kontributi të drejtpërdrejtë në ndërtimin e institucioneve, qeverisjen e mirë dhe një administratë publike shqiptare të çliruar nga korrupsioni, duke fuqizuar shtetin e së drejtës dhe duke përgatitur vendin për anëtarësimin në Bashkimin Europian;
- Një instrumenti efikas jo vetëm në parandalimin, por dhe ndëshkimin e korrupsionit në sektorin publik;

- Një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditje të praktikave korruptive në vendin e punës nga punonjësit e një autoriteti publik apo subjekti privat.

Me synim:

- Fuqizimin e luftës kundër korrupsionit duke përmirësuar mekanizmat ligjorë, masat politikë-bërëse;
- Adresimin e fuqizimin e ligjit, duke promovuar informimin e rasteve korruptive si një instrument në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në Shqipëri;
- Ngritjen e mekanizmave të mirëfilltë mbrojtës nga veprimet hakmarrëse e diskriminuese për sinjalizuesit, të cilët nuk janë indiferentë në vendin ku punojnë ndaj padrejtësive, si dhe zgjedhin të kontribuojnë aktivisht në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1012, datë 22.11.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 20.3.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020”;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 330, datë 28.05.2014 “Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”;

Palët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1  
Objekti

Bashkëpunimi i palëve për krijimin e një mekanizmi të ri denoncimi dhe goditje të veprimeve apo praktikave të dyshuara të korrupsionit në vendin e punës nga punonjësit e një autoriteti publik apo subjekti privat, mbrojtjen e individëve sinjalizues si dhe nxitjen e sinjalizimit.

Neni 2  
Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**, angazhohet në kuadër të bashkëpunimit:

- Të asistojë përmes mbështetjes së ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë, institucionet shtetërore për të përgatitur aktet nënligjore udhëzimet përkatëse për autoritetet publike dhe format e raportimit të ndjekjes dhe hetimit nga ILDKPKI-ja për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji;



- Të organizojë një vizitë në Mbretërinë e Vendeve të Ulta, në institucionet homologe përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- Të organizojë në bashkëpunim me ekspertët, konsultimet me grupet e interesit për prezantimin e akteve nënligjore dhe marrjen e rekomandimeve prej tyre;
- Të përgatisë në bashkëpunim me ekspertët kurrikulën e trajnimit për administratën publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të organizojë në bashkëpunim me ekspertët trajnime dhe të ofrojë asistencë teknike për stafin e ILDKPKI-së në lidhje me zbatimin e suksesshëm të ligjit dhe akteve nënligjore, përgatitjen e përshkrimit të punës për stafin përgjegjës për marrjen e sinjalizimeve dhe ndjekjen e tyre;
- Të organizojë fushatën ndërgjegjësuere dhe edukuese në media për ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij në luftën kundër korrupsionit.

**ILDKPKI, angazhohet në kuadër të bashkëpunimit:**

- Të caktojë një person përgjegjës përfaqësues të institucionit për mbajtjen e komunikimit zyrtar me institucionin dhe palët e tjera të përfshira në projekt;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave përgjegjës të ILDKPKI në takimet e grupit të punës që do të zhvillohen me ekspertët e PSH-së, përfaqësuesit e Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore dhe institucioneve të tjera;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave përgjegjës të ILDKPKI në një vizitë në Mbretërinë e Vendeve të Ulta, në institucionet homologe përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave përgjegjës të ILDKPKI në takimet konsultuese me grupet e interesit për prezantimin e akteve nënligjore dhe diskutimin e tyre;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave përgjegjës të ILDKPKI në trajnimet dhe asistencën teknike që do të organizohet për ta nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe ekspertët që do të punojnë me zhvillimin e akteve nënligjore dhe përgatitjen e udhëzimeve e formave të raportimit;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave përgjegjës të ILDKPKI në debate televizive që do të organizohen për ndërgjegjësim në lidhje me sinjalizimin dhe legjislacionin e zbatimit të tij.

**Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, angazhohet në kuadër të bashkëpunimit:**

- Të koordinojë punën me institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe me gjithë aktorët e përfshirë apo që pritet të përfshihen e kontribuojnë për këtë çështje;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucionit në takimet konsultuese me grupet e interesit për prezantimin e akteve nënligjore dhe diskutimin e tyre;
- Të sigurojë pjesëmarrjen e personave të institucionit në debate televizive që do të organizohen për ndërgjegjësim në lidhje me zbatimin e legjislacionit mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Neni 3  
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zbatohet deri në përfundim të projektit.
2. Palët do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshje. Komunikimi në çdo rast do të jetë në formë të shkruar.
3. Marrëveshja përpilohet në 6 (gjashtë) kopje dhe secila palë mban nga një kopje të njëjtë.

**PËR INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

**Shkëlqim GANAJ**

**PËR MINISTRIN E SHTETIT  
PËR ÇËSHTJET VENDORE  
KOORDINATOR KOMBËTAR  
KUNDËR KORRUPSIONIT**

**Bledar ÇUÇI**

**PËR PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE  
ZHVILLIM**

**Juliana HOXHA**

